



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.08.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, datë 02.08.2016
2. Vazhdimi i shqyrtimit të projektligjit “Për rivleresimin kalimtar të Gjyqtareve dhe Prokurorëve në RSH”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Keltis Kruja, Gent Strazimi, Fatmir Mediu, Petrit Vasili, Vexhi Muçmata, Aldo Bumçi.

Mungojnë:

Spartak Braho, Arben Ristani.

Të ftuar:

Rainer Deville – ekspert i Nivelit të Lartë

Jon Smibert – ekspert i Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Mund të fillojmë mbledhjen e komisionit, meqenëse kuorimi është i realizuar.

Mbledhja e komisionit do të vazhdojë aty ku është lënë nga mbledhja e herës së kaluar, në të cilin kemi dëgjuar një opinion paraqitur nga deputetët e opozitës, lidhur me projektligjin e vetingut.

Ky opinion u është dhënë ekspertëve, që kanë punuar me projektligjin, për të dhënë vlerësimet e tyre edhe të asaj çfarë ata përfaqësojnë në rastin e ekspertëve ndërkombëtarë, sepse ky është një projektligj, siç e kam thënë shumë herë të tjera, i hartuar kryesisht nga ekspertët ndërkombëtarë për një arsye fare të thjeshtë, por shumë të rëndësishme, sepse nuk ka një model, nuk ka një standard dhe është një ligj shumë, shumë i vështirë, por janë marrë eksperiencat të ndryshme, janë studiuar eksperiencat të ndryshme, më e mira e këtyre eksperiencave, dhe është arritur të jetë një ligj i kompletuar si ky që kemi sot, i cili është produkt i drejtpërdrejt i ekspertëve ndërkombëtarë, por edhe i kancelarive ndërkombëtare, i zyrave juridike të tyre, të cilat për dy arsye themelore, për shkak të rëndësisë që ka projektligji, veçorisë që ka projektligji, nga njëra anë, por, edhe nga ana tjetër, faktit që Brukseli në mënyrë shumë aktive, por edhe Uashingtoni, përmes zyrave të tyre këtu, do të jenë të përfshirë aktivisht në këtë proces, përmes EURALIUS-it dhe OPDAT-it, si edhe strukturave të tjera, që do të atashohen, në përputhje me rregullimet kushtetuese dhe ligjin e vetingut për kryerjen e këtij procesi në Shqipëri.

Në këtë kontekst, do të duhet të dëgjojmë pikërisht hartuesit e projektit dhe përfaqësuesit e EURALIUS-it dhe të OPDAT-it. Besoj se ata kanë konsideratën e kancelarive përkatëse përreth komenteve që janë bërë.

Zoti Rainer, urdhëroni!

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesi)* Të dashur anëtarë të komisionit,

Të dashur kolegë,

Ndryshimet kushtetuese përfshijnë një kontroll disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për shkak të detyrës së tyre, që është vlerësimi i vetingut. Një projektligj është mbi implementimin e ligjit të vetingut, që ka shkuar nëpërmjet konsultimeve publike që prej datës 1 korrik 2016. Pastaj ky komision ka diskutuar draft ligjin nen për nen. Më vonë është bërë një

vlerësim nga Partia Demokratike, janë bërë disa komente nga Partia Demokratike më 2 korrik 2016.

Në një numër të konsiderueshëm vërejtjesh janë bërë me qëllim për të përmirësuar tekstin dhe këto vërejtje janë të mirëpritura. Disa nga këto propozime përfshijnë:

Neni 3, pika 3 dhe nenet 8, 9 mund të harmonizohen në formulimin shqip.

Neni 3, pika 12 mund të hartohet në atë mënyrë duke përdorur shprehjen, siç është parashikuar në nenin 75/a.

Neni 3, pika 17, mund të ndryshohen pak inicialet.

Neni 3, pika 20 mund të bëhet më i qartë nëse në nenin 45 të përfshihet edhe fjala “tjetër”.

Referimi që i bëhet ligjit mbi punonjësit civil dhe objektit të kandidatëve potencialë, në nenin 3, pika 21, mund të ndryshohet duke shtuar “me përjashtim të anëtarëve të kabineteve në gjykata, në prokurori dhe në zyrën e Avokatit të Popullit”.

Neni 5, paragrafi 2 mund të ndryshohet në versionin shqip.

Në nenin 6 mund të hiqet gjithashtu “ata ekspertë, të cilët janë emëruar nga partitë politike dhe nga Ministri i Drejtësisë.” Kjo është diçka që është rënë dakord në nivel politik.

Neni 7, paragrafi 2 mund të harmonizohet në versionin anglisht, duke përfshirë fjalën “President”.

Neni 7 paragrafi 6, mund të ketë një fjali të dytë “misioni ndërkombëtar i monitorimit duhet të arsyetojë vlerësimet e tij.”

Neni 7 mund të shtohet një paragraf të ri, duke pasur parasysh Nenin c, paragrafin 12 të ndryshimeve kushtetuese, ku mund të thuhet që standardet procedurale të Kuvendit mund të aplikohen.

Neni 12, paragrafet 1 dhe 5, mund të bashkohen dhe numrat respektivë të nenit mund të ndryshohen.

Neni 17 mund të përfshijë, gjithashtu, edhe çdo detyrë tjetër administrative të caktuar nga kryetari.

Neni 28 mund të zgjerohet me një fjali, që është propozuar edhe në faqen 26 të këtyre komenteve. Nëse neni 33 ndryshohet, atëherë neni 46, pika 2/a duhet të përfshijë edhe veprat kriminale.

Neni 34, paragrafi 7 do të bëhet pika d e paragrafit 6.

Neni 39, paragrafi 2 mund të rregullojë zgjedhjen e rastësishme të 5 dosjeve. Nëse neni 42, paragrafi 4 do të hiqej fjala “zyrtare”, duhet të fshihet nga paragrafi 1.

Neni 46, paragrafi 7 mund t’i referohet ministrisë kompetente. Kjo mundëson kërkesat formale të bazuara në bashkimin ndërkombëtar nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, si dhe kërkesave diplomatike nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 47, paragrafi 2 duhet të kuotojë nenin 45.

Neni 54 mund të riprezantojë numrin e madh të studentëve për Shkollën e Magjistraturës edhe pse kjo është propozuar dhe rregulluar në dispozitat tranzitore të ligjit mbi organet qeverisëse. Duplikimi në këtë rast nuk e dëmton procesin, por e ndihmon atë, nëse këto ligje nuk aprovohen së bashku në një paketë.

Neni 64 mund të përfshijë edhe prokurorët.

Neni 65, paragrafët 1 dhe 2 mund t’i japin një afat të tillë si: “30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Edhe disa ide të tjera, që janë konsideruar të vlefshme pas një vlerësimi të kujdesshëm, rekomandohet të përfshihen në projektligjin ekzistues.

Unë do të shikoja disa prej këtyre shembujve tipik.

Është sugjeruar që në ligjin për vetingun të mos përfshihen çështjet që janë ende në diskutim. Në fakt, kjo tashmë është e rregulluar. Është në Kushtetutë në aneksin e Kushtetutës, neni E paragrafi 2, fjalia e fundit.

Në lidhje me mënyrën e llogaritjes së afateve ka një referencë në Kodin e Procedurës Administrative, në nenin 4, paragrafi 6, i cili i referohet nenit 56 të Kodit të Procedurës Administrative.

Pse komisionerët publikë kanë nevojë për një eksperiencë 10-vjecare? Ata nuk vendosin mbi substancën e çështjeve dhe ushtrojnë vetëm të drejtën e apelimit dhe kjo mundëson një numër më të madh kandidatësh potencialë për t’u bashkuar në atë sistem.

Fatmir Xhafaj – Përpara se të filloni përkthimin, ju lutem, ka një defekt teknik. Mbylleni mikrofonin.

Ju lutem, ju kërkohet ndjesë! 2 minuta.

Mund të vazhdojmë.

Rainer Deville – (përkthen përkthyesi) E fundit, por jo më pak e rëndësishme. Më lejoni të përdor këtë rast për të shpjeguar 4 parime, të cilat për BE-në janë esenciale për këtë reformë.

Një afat kohor apo një kalendar për çdo çështje individuale mund të mos ekzistojë. Në procesin e vlerësimit administrativ, Kodi i Procedurës Penale nuk aplikohet dhe çdo çështje individuale vendoset ose zgjidhet për aq shpejt sa të jetë e mundur. Të gjitha çështjet fillojnë menjëherë pasi barra e provës i bie personit që vlerësohet procesi i rregullt kërkon kohë të mjaftueshme për hetimet dhe për mbledhjen e provave. Procesin e vetingut përdor informacionin ekzistues, dosjet dhe strukturat administrative dhe në veçanti ato të ILDKPI-së për vlerësimin, për skanimin e pronës dhe përdor policinë dhe autoritetet e inteligjencës për vlerësimin e figurës. Njohuritë dhe kompetencat e tyre janë të nevojshme dhe nuk mund të zëvendësohen nga stafi i ri apo nga struktura të reja. ILDKPI-ja, roli i saj është i parashikuar në Kushtetutë dhe nuk mund të vihet në pikëpyetje. Roli i saj është që të parashikojë të gjithë informacionin që ato kanë, por jo konkluzionet të cilat në të vërtetë janë për organet e vetingut. Implementimi i vetingut, hetimi dhe vendimi përfundimtar bëhet gjithmonë nga institucionet e vetingut nën monitorimin ndërkombëtar. Roli i misionit të monitorimit ndërkombëtar nuk mund të reduktohet. Monitorimi ndërkombëtar i dizenuar është një instrument kyç për t'i mundësuar publikut për të rimarrë besimin në gjyqësor. Bashkëpunëtorët e drejtësisë, neni 50, vlerësohet si një mjet i rëndësishëm për të hyrë në praktikën korruptive dhe për të grumbulluar provat përkatëse.

Pjesëmarrja e publikut është kyçe për të ndryshuar mentalitetin në lidhje me korrupsionin. Komisioni Europian më ka kërkuar për të theksuar që këto parime janë vendimtare për angazhimin e BE-së në procesin e vetingut duke mobilizuar kështu miliona euro nga fondet e taksapaguesve europianë. Nëse ligji mbi statusin me dispozitat në lidhje me vlerësimin nuk do të aprovohej në këtë paketë, dispozitat përkatëse mund të përfshihen në ligjin e implementimit të vetingut. Këto janë dizenuar në mënyrë të ndryshme, por teknikisht është e mundur. BE-ja shpreson se partitë do të gjejnë një mënyrë për të ndjekur thirrjen e Presidentit të Republikës për të aprovuar ligjet që mungojnë sa më shpejt që të jetë e mundur pa të cilat ndryshimet kushtetuese nuk mund të implementohen plotësisht.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Rainer!

Ka koment tjetër nga ekspertët?

Po, zoti Smibert.

Jon Smibert – *(përkthen përkthyesi)* Do doja të thoja shkurtimisht se ky është një ligj që ka të bëjë me një moment të caktuar në historinë e Shqipërisë. Një nga pikëpamjet e këtij ligji është se ky ligj mbështetet në institucionet ekzistuese.

Ky ligj përpiqet të përfshijë institucionet ekzistuese dhe informacionin ekzistues për vlerësimin e kontrollit të figurës në mënyrë që të lejojë këtë institucion të jetë në gjendje të bëjë punën e saj në bazë të informacionit që kanë. Një nga aspektet për vlerësimin e kontrollit të figurës, për të cilën z. Deville më ka kërkuar të komentoj mbi të, është një nga shqetësimet që ka shtruar opozita. Ekzistojnë institucione brenda qeverisë ku informacioni nuk trajtohet në mënyrë të rregullt. Për sa i takon informacionit që kemi në lidhje me vlerësimin e figurës është një informacion i cili mund mos jetë i plotë por që kryesisht ekziston. Ne përdorim të njëjtën procedurë në Shtetet e Bashkuara dhe vendet anëtare të NATO-s, kur kemi të bëjmë me këto lloj vendimesh. Këto vendime duhen marrë parasysh duke respektuar këto standarte. Në qoftë se informacioni nuk ekziston, atëherë nuk mund të mbështetemi në këto standarte, por kur ky lloj informacioni ekziston mund të analizohet në bazë të standarteve. Ashtu sikurse dhe në shtete të tjera, për shembull si veprojmë në Shtetet e Bashkuara kur analizohet informacioni dhe pastaj u dërgohet një propozim organeve vendimmarrëse. Në këtë rast organi vendimmarrës është Komisioni i Vetting-ut. Kjo reflekton shqetësimin e ngritur më herët nga opozita në lidhje me vlerësimin e kontrollit të figurës se si mund të sigurohet që është një proces ligjor dhe i drejtë për të analizuar informacionin që ekziston dhe më pas u dërgohet një propozim organeve vendimmarrëse. Harmonizimi i këtij procesi përfshin disa nga shqetësimet e ngritura nga opozita.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Dëgjuam ekspertët lidhur me komentet e bëra. Ka pyetje?

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Pyetja, së pari, është procedurale.

E para, unë vlerësoj punën dhe këtë prezantim të shkurtër nga i cili nuk jemi në gjendje të vlerësojmë të gjithë këtë analizë që kanë bërë ekspertët. Është i pamjaftueshëm, megjithatë jam i sigurt që ka më shumë sesa kaq. Përtej kësaj kohe të gjatë, që nga momenti kur ne kemi bërë mbledhjen e fundit, këto që dëgjuam a janë me shkrim, të disponueshme për anëtarët e komisionit?

E dyta, duke qenë se në vijim të asaj që tha kryetari, me të drejtë e filluam aty ku e lamë herën që shkoi, ku porosia që u la në këtë komision pas dorëzimit të opinionit në vija të përgjithshme, por në detaj me një dokument shumë të detajuar, detyra iu la ekspertëve pas asnjë lloj dallimi. I referohem të gjithë potencialit të ekspertizës që ka komisioni përfshirë dhe ekspertët e opozitës të ulëshin, të diskutonin nen për nen, në detaje, të shkëmbenin opinionet, komentet, dhe të rakordonin materialet. Unë shoh një material të përfunduar nga ju ekspertët dhe

mbi të pastaj të punojmë ne. A ka ndodhur gjatë kësaj periudhe ndonjë tentativë për të rakorduar teknikisht qëndrimet përpara se ekspertët të gjithë t'i vijnë komisionit. Pra, ka dy gjëra. Dokumentet a janë të disponueshme? A është rakorduar teknikisht, siç është praktika e të gjithë komisioneve të mëpërparshme?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesi)* Vlerësimi i BE-së është bërë në zyrat e Brukselit dhe ne mund t'ua lëmë në dispozicion vetëm sot. Ky vlerësim përfshin të gjitha ndryshimet që ne gjykojmë se janë të nevojshme.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Ka komente? Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, të gjithë bien dakord, e kemi thënë herën e kaluar për rëndësinë e këtij ligji. Jam i sigurt për këtë që dakord bien dhe ekspertët ndërkombëtarë. Nuk ka standard ndërkombëtar për ligjin e vetingut, nuk ekziston, nuk ka praktikë të mirë. Të gjitha ato praktika të limituara që ekzistojnë janë me probleme, kështu që jemi shumë të interesuar që eventualisht ta kemi ne, ta hapim ne rekordin e praktikës së mirë. Se duke munguar këto të dyja, ndërkohë mungon dhe jurisprudenca e nevojshme, krahasuese, kushtetuese ndoshta dhe aq më pak e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ajo që na bën punë të gjithë ne dhe na shpëton në këtë proces kaq të jashtëzakonshëm dhe të vështirë, që duhet të dalë me sukses, është që t'i qëndrojmë pikë për pikë parimeve të shtetit të së drejtës, pavarësisht gjyqësorit dhe të drejtave të njeriut. Për këtë na ndihmon Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut dhe doktrina e përpunuar nga Komisioni i Venecias, një pjesë të së cilës e kemi para nesh nëpërmjet dy opinionesh, më i rëndësishmi ai final. Por ai është për tekstin kushtetues. Për këtë ligj që shkon dhe detajon tekstin kushtetues, i cili mund ta përmirësojë ose ta përkeqësojë, sigurisht ende nuk kemi një opinion nga një organ më autoritar i cili është Komisioni i Venecias. Ne në takimin tonë të fundit kemi parashtruar disa piketa në parim për këtë projektligj. Projektligji nuk ka detaje dhe procedura të cilat rregullojnë strukturat e përfshira në proces. Nuk ka afate të qarta në lidhje me procesin. Nëse ky ligj me të gjithë këto mangësi rrotull tij nuk i ka këto ne mund të përballemi me probleme të rënda që na nxjerrin nga shinat këtë proces që duam ne bashkë të mbylлим këtu. E para.

E dyta, nuk ka garanci të qarta për organet e vetingut dhe anëtarët e tyre përfshirë personelin, të cilat do ta bënin këtë proces të pavarur dhe të pakapur.

E treta, nuk mund të jetë rastësor procesi, por duhet të jetë i parashikueshëm deri në fund fare të tij me kalendarë, me mënyrën e përzgjedhjes. Aq më e qartë është për të gjithë edhe për publikun. Bëhet më i besueshëm për publikun. Sa më selektiv dhe i rastësishëm aq më pak besim dhe aq më pak transparent është ky proces, dhe për rrjedhojë përsëri na bie themeli i procesit. Ne nuk e duam këtë.

E katërta, duhet patjetër që projektligji, duke qenë se Komisioni i Venecias e thotë se ky është një rast i jashtëzakonshëm, duke qenë se thotë se nuk duhet të jetë një proces selektiv politik, por duhet të jetë një proces i përgjithshëm, duhet të vendosim rregullat për një proces të drejtë ligjor që mungojnë në analizën tonë. Përndryshe do të përballemi me problemet që i ka thënë Komisioni i Venecias, mund të na dalin më pas në Gjykatën Kushtetuese apo dhe më larg se sa aq, në Gjykatën e Strasbugut. Asnjë nga ne nuk e do këtë.

Dhe e fundit, ligji ka një seri të madhe problematikash teknike, qoftë të teknikës legislative, qoftë të problematikave të tjera të cilat duhen patjetër për një ligj kaq të rëndësishëm, duhet të jenë atje. Ligji duhet të jetë patjetër i detajuar dhe shumë preciz, përndryshe ligji mund të na çojë në situata konfuze dhe ne nuk na duhen situata moszbatimi si dispozitat kushtetuese në këtë moment. Mua më vjen mirë që ju në këtë që prezantuat pranoni se është një numër i madh dispozitash që do të jenë të nevojshme të ridiskutohen teknikisht para se t'i vijnë komisionit për miratim. Sa më shumë të bëhet nga kjo aq më pak diskutim ka mes nesh, sepse në fund të fundit shumica këtu jemi në profesion si juristë. Mbetet për t'u parë pasi ta keni prezantuar të detajuar dhe të uleni ta diskutoni si ekspertë.

Dëgjuam këtu të gjithë disa komente në lidhje me një qëndrim për sa i përket çfarë mund të bëhet ose jo për shkak se e parashikon Kushtetuta. Në fund fare sigurisht si çdo trupë ekspertësh ka të drejtën që në gjykimin më të mirë të mundshëm të ekspertit të na prezantojë ne versionet përfundimtare ku do t'i çmojmë ne këtu, për ta mbyllur se çfarë bënë dhe çfarë jo. Opinioni ynë është i shprehur, për sa i përket gjysmës këtu. Kështu që është mirë të uleni dhe teknikisht t'i zgjidhni. E kuptoj që ishte një parashtrim nga më të thjeshtat deri te çështjet më kryesore. Sigurisht që ka më shumë çështje kryesore që ne ngremë si problem nga sa dëgjuam në këtë prezantim të shkurtër. Por për shembull, fakti që procesi do të vazhdojë të mbetet i varur tek organe që janë në varësi të plotë të ekzekutivit ose të prekura qoftë nga korrupsioni apo nga korruptimi politik, sigurisht që risku është shumë i madh që na cenohen themelet e procesit gjatë një periudhe 5 deri 9-vjeçare. Asnjë nga ne nuk e do këtë dhe për këtë jam i sigurt. Janë

institucione të cilat që po të kishin qenë në gjendje e kishin bërë punën deri më sot, por dimë dhe situatën në të cilën janë. Edhe ky mbetet një vlerësim pragmatist. Ndërkohë që në këtë proces që kemi vendosur të ndryshojmë Kushtetutën për të bërë një gjë kaq të rëndësishme për të ngritur organe kushtetuese, paralele dhe të përkohshme ku angazhohen miliona euro nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i taksapaguesve evropianë dhe i Shteteve të Bashkuara, unë besoj se gjëja më e drejtë ne besojmë e keni në opinionin e paraqitur nga ne, gjëja më e drejtë është që këto organe të mos jenë thjesht kukulla që në fund fare mund të marrin një vendim edhe të prekur politikisht apo edhe më keq se aq, por t'i kenë të gjitha kapacitetet e tyre me ndarjen e brendshme, të nevojshme për sa i përket mbledhjes së fakteve, analizës dhe vendimmarrjes, por në këto organe kushtetuese, sepse përndryshe ishte shumë e thjeshtë me ILDKPI-në, Policinë e Shtetit, DSIK-në ia jepnin KLGJ-së dhe KLP-së dhe e mbyllnin ata procesin. Ne thamë jo. Na duhet një proces, i cili do të bëhet në mënyrë paralele nga organe të reja kushtetuese në mënyrë të përkohshme. Po fusim një luan në këtë proces, le t'i japim edhe dhëmbët këtij luani, të mos ia japim tjetër kujt! Kështu që unë shpresoj se në materialin që do të shohim do të ketë më shumë sesa dëgjuam. Kuptova, edhe nga përgjigjja, që nuk ka pasur asnjë koordinim deri më sot, për shkak të kohës fizike që është dashur, për të përgatitur këtë material midis ekspertëve. Sigurisht, ekspertët janë ata që kanë draftuar të gjithë këtë legjislacion, duke filluar që nga versioni i shtatorit i Kushtetutës, i janarit i Kushtetutës, punë sado e lavdërueshme, por opinionin e Komisionit të Venecias dhe kontributi i opozitës kanë bërë që të ndryshojë në mënyrë thelbësore dhe të vazhdueshme, sepse Komisioni i Venecias është arbitri i kësaj historie dhe askush tjetër.

Në eksperiencat më të mira që ka ekspertiza ndërkombëtare, gjithmonë ekspertizën më të mirë e ka pasur këtu, nuk e ka pasur diku tjetër. Kështu që gjykoj se, meqë ju e keni të plotë pozicionin tuaj, duke qenë se edhe pozicioni ynë është shumë i qartë dhe i plotë, është e rëndësishme që të ulen ekspertët dhe ta mbyllin maksimalisht versionin në aspektin teknik dhe çështjet me një karakter vendimmarrjeje për komisionin të na i lënë neve si komision. Pra, është Komisioni i Venecias ai që është arbitri dhe askush tjetër, ai nuk e ka parë ende këtë projektligj, që është shumë i rëndësishëm. Kanë shkuar projektligje edhe më pak të rëndësishëm se ky në Komisionin e Venecias. Megjithatë, ne të bëjmë punën tonë. Unë, si gjithë të tjetër, pres që t'i marr me shkrim këto komente që ju bëtë. Sigurisht, nuk do t'i shoh si komente mbi komentet tona, por si reflektime të punës suaj. Ajo që ne të paktën presim është që, në mënyrë të përbashkët, të na vini me një dokument final. Gjykojeni kohën, por unë propozoj që ditën e hënë,

mbetet për t'u rënë dakord, zoti kryetar, të kemi një material, i cili të paktën të ketë një lloj dakordësimi midis ekspertëve për të gjetur zgjidhje jo vetëm të aspektit teknik, por edhe për ato çështje të rëndësishme, thelbësore që ne kemi ngritur, pra diskutim, jo shkëmbim komentesh.

Besoj se janë shumë të arsyeshme këto që thashë, kështu që shpresoj të ketë një reflektim për to.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka komente të tjera?

Po, zoti Majko, i cili është edhe relator i projektligjit që po shqyrtojmë.

Pandeli Majko – Edhe si relator i projektligjit, dëshiroj të them, së pari, që ne jemi duke ridiskutuar projektligjin në fjalë, pasi ky komision e ka kaluar edhe nen për nen këtë projektligj. Por, nisur nga vërejtjet që paraqitën kolegët e opozitës, ne kërkuam një reflektim edhe nga institucionet ndërkombëtare. Më duket se kjo e fundit është e rëndësishme të thuhet, pasi zoti Rainer nuk foli me gjuhën e ekspertit, por, ashtu siç e përktheva unë apo përkthyesi, ai shumë qartë tha se ky nuk është opinioni i tij personal, por është opinioni i BE-së. Pra, po flasim për opinionin e BE-së. Prandaj, nisur nga kjo që sapo thashë, mendoj se ne mund të ecim tanimë duke pasur një opinion zyrtar. Në ka institucion që do ta monitorojë në mënyrë esenciale këtë proces, që është procesi i vetingut, bashkohem me kolegun parafolës kur tha që nuk ekzistojnë praktikatat më të mira, që do të thotë se nuk mund të bëhemi zëdhënës së asnjë lloji praktike, por duhet t'i besojmë një institucioni më përgjegjës se ne, të paktën bazuar në intencionin që kemi si përfaqësues të një vendi që kërkon të bëhet anëtar i BE-së, dhe t'i besojmë atij pak më shumë sesa ideja se ne jemi më të mirët në këtë histori.

Mendoj se mbi këto komente zyrtare të BE-së ne të nxisim grupin e ekspertëve, që të reflektohen të gjitha vërejtjet që janë pranuar në këto komente bazuar mbi vërejtjet e opozitës. Por për vërejte ato që nuk mund të konsiderohen të pranuar nuk kemi se çfarë të diskutojmë më tepër për dy arsye.

Së pari, ne nuk po diskutojmë asgjë politike këtu, po diskutojmë një projektligj në zbatim të neneve kushtetuese, të cilat i miratuar me konsensus.

Së dyti, duke qenë se tani faktori ndërkombëtar nuk është thjesht vëzhgues, por është monitorues dhe mbikëqyrës bazuar mbi aneksin kushtetues, të cilin ne e kemi miratuar së bashku, mendoj se dhënia e një opinioni të tillë mbetet esenciale për vazhdimin dhe votimin

fundor, shterues së këtij projektligji në Kuvend. Prandaj si relator mendoj t'ju propozoj që, bazuar mbi këto komente, të reflektohen të gjitha ato që, siç e thashë edhe pak më parë, u pranuan nga komentet zyrtare të BE-së, ndërsa për ato që nuk konsiderohen të pranuar shpreh keqardhjen dhe i ftoj kolegët e opozitës që herën tjetër të fillojmë me votimin nen për nen, sipas gjykimit të ekspertëve.

Mendoj se përgjigjet ish-in shteruese, qofshin këto për disa nga ato që ngriti në parim kolegu parafolës, që kanë të bëjnë qoftë me rolin e ndërkombëtarëve, qoftë me strukturën organizative, qoftë me faktin e procedurës së përzgjedhjes, qoftë me rolin e DSIK-së apo të ILDKPI-së. Mendoj se ne jemi një komision që, pas miratimit të Kushtetutës dhe aneksit kushtetues, mbi të cilin do të mbështetet veprimi i këtij ligji që po diskutojmë, nuk na lejohe të bëjmë cedime, pasi në fund fare e kemi votuar atë me konsensus. Të paktën kjo është ajo çfarë kam parë unë në sallën e parlamentit. Me këtë frymë besoj dhe mendoj se duhet të vazhdojmë të diskutojmë ndryshimet që do t'i kalojmë përsëri me konsensus.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Ka komente të tjera nga kolegët?

Po, zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri – Edhe unë do të doja të falënderoja ekspertët për prezantimin që bënë! Ndryshe nga kolegët, sot e kam të pamundur, për shkak të mënyrës sesi, me përkthim simulant, të kem një ide të qartë mbi materialin që është shumë kompleks. Sigurisht, edhe unë kam nevojë ta lexoj dhe ta kem përpara.

Ndryshe nga zoti Majko, që nga dita e parë që jemi ulur në këtë tryezë, unë vazhdoj të kem nevojë ta lexoj dhe të mendoj mirë mbi materialin. Pra, unë ndryshe nga zoti Majko, që thoshte se nuk kishte nevojë ta lexonte, por ta votonim që ditën e parë, sepse nuk kishim pse ta lexonim. Por për shkak të insistimit tonë për këtë material konsensual dhe besoj se kemi bërë mirë, tani jemi të gjithë krenarë, sepse kemi një material të ndryshimeve kushtetuese, i cili na bashkon dhe mbi të cilin duhet të vazhdojmë, me të njëjtën frymë, të punojmë për të nxjerrë po ashtu edhe ligjet, që të jenë funksionalë, jo disfunksionalë. Sigurisht, sa më transparentë, që ta kemi të qartë se çfarë do të ndodhë, kur dhe çfarë momenti në vitet që vazhdojnë, në mënyrë që kjo të jetë një reformë afatgjatë, e qëndrueshme, që realisht, pas implementimit të plotë të saj, të jemi krenarë që kemi shpenzuar këto ditë gushti, të paktën, duke punuar.

A është i mjaftueshëm opinioni? A është përfundimtar? Opinioni mund të jetë i zyrës juridike të BE-së. Po ashtu nuk dua të vë barrierën finale, është thënë dhe mbaroi, kështu e do BE-ja, është një zyrë opinioni për të cilën kam shumë respekt. Por mua nuk më duket tabu që nëse kemi nevojë... Thashë nuk e kam lexuar ende materialin, nuk e kam parë, sot nuk mund të arrij në një opinion. Po ashtu, institucioni i BE-së, i krijuar pikërisht për të marrë të tilla opinione, është Komisioni i Venecias, nuk është një institucion ekstraeuropian, është një institucion i pavarur, i përbërë nga akademikë pikërisht për të marrë të tilla lloje mendimesh, për të na ndriçuar në këtë lloj jurisprudence. Kështu që nuk do të vendosja barrierën fundore, e kemi marrë këtë tani dhe nuk na duhet gjë tjetër, jo, veçanërisht pas ndryshimeve kushtetuese, që, në fund të fundit, kanë dhënë thjesht qëllimin tonë të përbashkët për të reformuar sistemin dhe për të krijuar mekanizma të tillë, që ta kontrollojnë të mos bie më në zullumet që ka rënë deri tani, duhet të jemi edhe më të kujdesshëm, sepse çdo mekanizëm, çdo instrument i pakujdesshëm që mund të promovojmë mund të na çojë në deformimin e qëllimit të përbashkët që kemi pasur. Kështu që duke mbetur me shpresë të plotë që materiali dhe komentet e ekspertëve të nivelit të lartë, ekspertëve të huaj do të na vijnë sa më shpejt dhe të kemi mundësinë t'i shikojmë dhe t'i lexojmë rresht për rresht, edhe unë mbetem me shpresën se do të vazhdojmë të ecim me të njëjtën cilësi që patëm gjatë kësaj periudhe, veçanërisht ditët e fundit, kur miratua me konsensus ndryshimet kushtetuese. Duke u përpjekur që të gjithë bashkë të gjejmë diçka të mesme, të mos nxito kemi për ta mbaruar shpejt në dëm të cilësisë, dhe të mos i japim vetes më shumë kohë nga ç'duhet, duke përdorur si pretekst cilësinë. Duhet të jemi të gjithë në frymën e konsensusit që patëm në lidhje me amendamentet kushtetuese.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Edhe një herë, që të jemi të qartë, vlerësoj punën, por nuk e kam parë ende thellësinë e reflektimit të ekspertëve. Ekspertët nuk kanë ardhur të gjykojnë opinionin e opozitës, ata kanë për detyrë të integrojnë shqetësimet tona, të cilat shkojnë deri në shqetësime që mund të prekin standarde ndërkombëtare dhe asnjërit prej nesh nuk i duhet kjo.

Në diskutimin qoftë në atë që tha përfaqësuesi i EURALIUS-it, qoftë në atë që tha kolegu Majko dëgjova që komisioni ka diskutuar dhe miratuar nen për nen një draft. Përveç faktit që diskutimi është bërë përpara miratimit të Kushtetutës, të gjithë e dimë që është një diskutim që

është bërë në mënyrë të njëanshme, maxhoranca ka biseduar dhe miratuar me veten e saj për një proces kaq të rëndësishëm. Arsyeet pse ne nuk ishin në atë proces ishin të qarta, Kushtetuta nuk ishte miratuar dhe askush nuk e dinte ekzakt se çfarë do të ndodhte më pas. Fat i madh, ne sot e kemi Kushtetutën, edhe në fuqi! Sigurisht, ky parlament nuk merr përsipër që të miratojë dhe të diskutojë dispozita në mënyrë finale, sepse do ta ishte gabim i madh që të miratojë gjëra që bazën kushtetuese nuk e kanë, fare, zero. Në çdo rast, në të shkuarën, çdo diskutim i ligjit është bazuar qoftë edhe në një nen të vetëm të Kushtetutës, kurse ky nuk e kishte fare. Për rrjedhojë vlera e atij diskutimi, ta themi të gjithë, në aspektin kushtetues, ligjor, teknik, por edhe politik është të mos themi zero, sepse është bërë punë, nuk kemi nevojë të fillojmë nga fillimi. Kështu që ky argument nuk vlen. Ne do të ulemi ta diskutojmë tani dhe do ta miratojmë nen për nen. Po ashtu pashë theksimin e kolegut Majko në lidhje me faktin që ne duhet të kuptojmë se cili është pozicioni ndërkombëtar i BE-së. Këtë e kuptojmë të gjithë, është shumë e thjeshtë. Sigurisht, ky është një diskutim i një trupe politike me një trupë fare teknike.

Ne e kemi shumë të qartë pozicionin e Komisionit Evropian në letrën që dërgoi komisioneri Han dhe ishte një letër themelore në zgjidhjen përfundimtare që u dha, ku e përcakton shumë qartë, dhe jemi të gjithë 100% dakord, rolin e ONM-së. Rol me një kompetencë monitorimi, me rekomandime, të cilat nuk kanë efektin ligjor, por ne të gjithë e dimë shumë mirë se çfarë efekti kanë, ama vendimet do t'i marrin shqiptarët. Nëse shqiptarët vendimet i marrin të korruptuara, të thotë çfarë të dojë ONM-ja, vendimmarrja është e shqiptarëve, me probleme. Jo më kot ligji parashikon shumë arsye për humbjen e detyrës nga këta. Kështu që përpara se të fillojmë në këtë lloj diskutimi pas 1, 2 apo 5 vjetësh, le ta zgjidhim sot këtu në mënyrë të qartë, teknike, të padiskutueshme, ku arbitrin nuk e bëjnë ata që e shkruajnë ligjin, por e bëjnë të tjerë, me autoritetin dhe kompetencën që kanë. Mundet që punën që do të bëjmë ne ta kemi aq të mirë, sa që askush nuk do të ketë nevojë fare, zero të shkojë për të pyetur. Ne këtë po presim që të bëhet në ditët në vijim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zoti Majko ka një ndërhyrje tjetër.

Pandeli Majko – Unë shpresoj që po flasim shqip dhe jo anglisht, mund të flasim edhe anglisht dhe mbase kuptohemi më mirë, por unë më duket se fola qartë. Dëgjuam komentet e ekspertit të BE-së. Të ulen ekspertët e të dyja palëve dhe të nxjerrin ekstraktin që u takon neneve

përkatëse. Unë nuk e kuptoj se çfarë nënkupton me këtë lloj aludimesh gushti, se dielli rëndon pak: jo e marrim për ta lexuar, jo e diskutojmë pa lexuar, jo do ta kalojmë kështu, jo do ta kalojmë ashtu! Mendoj se historia është shumë e qartë: ne do të ecim mbi nenet kushtetuese që kemi miratuar së bashku me konsensus. Nuk do të kalojmë asnjë kufi të këtyre neneve kushtetuese. T'i lëmë historitë teorike apo politike me subjektivizmat tanë të zakonshëm, që i kemi diskutuar më parë këtu gjatë diskutimit kushtetues. Nuk besoj se i bën dëm njeriu sot të përsëritet se këtu se opinionet që dëgjuam në anglisht dhe në shqip janë opinione të një ekspertize teknike, janë vlerësime të BE-së për vërejtjet e dobishme dhe atje pati një vlerësim për vërejtjet e palës së opozitës, siç pati edhe një vlerësim jopranues për disa aspekte të tjera. Tani ekspertët të mblidhen dhe t'i diskutojnë. Nëse doni të dini opinionin tim: unë jam që t'i qëndrojmë parimit për të ecur në bashkëpunim të fortë me BE-në dhe OPDAT-in. Nëse juve ju duket se kjo histori ju prek "sovrانيتin" e vendimmarrjes së ashtuquajtur shqiptare, unë them që të mos e hapim këtë histori, sepse tani standardet shqiptare kemi pasur. Kur ofruat si grup parlamentar gjykimin apo hetimin e CEZ-it, na keni sjellë një histori që është e lemerishme krahasuar me këto teori që na hidhni sot për ruajtjen e sovranitetit. Projektligjin tuaj e kam lexuar në mes të parlamentit.

Do të zbatohet aneksin për këtë ligj. Pra, për ligjin "Për verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" do të zbatohet Aneksin A, B, C e me radhë, deri në fund fare, nuk do të bëjmë asnjë lloj shkence tjetër. Nëse juve ju duket se ka një autoritet tjetër që mund t'ju japë një vlerësim më të mirë, shkoni ku e mendoni ju të gjykueshme. Por ne kemi për detyrë ta vlerësojmë projektligjin bazuar mbi ato që kemi miratuar së bashku në Kushtetutë.

Po e përsëris edhe një herë, që të jetë e qartë për të gjithë, të ulen ekspertët dhe mbi bazën e komenteve që kanë ardhur nga BE-ja të procedojnë. Pse duhet ta shikojmë BE-në gjithë dyshime, se mos këta po na vijnë dhe po na fusin duart te vendimmarrja e jashtëzakonshme shqiptare që do ta ndriçojë këtë vend?! Lëri këto histori me armiq! Kjo sallë ka parë sa të duash, ju jeni lule!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Mediu keni fjalën.

Fatmir Mediu – Unë mendoj që t'i shmangim këto diskutime dhe kontestime pa vlerë me njëri-tjetrin dhe të hyjmë në procedurën formale dhe normale që duhet të kryejmë. Nuk është hera e parë që ne kemi materiale dhe opinione të ekspertëve vendas dhe të huaj. Ne si opozitë,

kemi paraqitur disa opinione mbi projektligjin, të cilat janë vlerësuar nga grupi i ekspertëve në BE. Kështu që, në të gjithë të drejtën, mendoj se duhet t'i kemi të shkruara sot që të kemi gjykim më të qartë për to. Ekspertët të ulen, mundësisht të zgjidhin të gjithë problematikën që mund të ketë diskutime. Do t'ju kërkoja ju, zoti Xhafaj dhe zotit Bylykbashi, që ta thërrisni mbledhjen e komisionit në kohën më të afërt të mundshme, që ne të procedojmë sa më shpejt.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Vasili, keni fjalën.

Petrit Vasili – Unë mendoj se ne ndodhemi në një moment ku edhe kemi, edhe nuk kemi kohë, sepse edhe puna jonë këtu kushtëzohet me mbledhjen sa më parë të parlamentit për miratimin e këtij projektligji, por edhe të dy projektligjeve të tjerë që kanë ardhur, për të cilët mendoj se duhet punuar me shpejtësi, pasi gjithçka që kemi bërë, e kemi bërë për t'i bërë gjërat në kohën dhe në momentin e duhur. Jashtë këtij momenti besoj se dalin edhe komentet, dalin edhe shume merake të tjera që mund të kemi. Ndaj, unë kam vetëm një ftesë shumë konstruktive dhe racionale: në morinë e gjërave që ne kemi apo që përfaqësuesit e opozitës kanë, të fokusohen një apo dy momente, që edhe fokusojnë punën, edhe lehtësojnë komunikimin që mund të kenë ekspertët, në mënyrë që të mos shkojmë përtej këtij limiti për një arsye shumë të thjeshtë, sepse kornizën sesi vendoset vetingu, bazën kushtetuese të tij ne tashmë e kemi kapërcyer dhe kemi bërë me mirëkuptim të përbashkët. Është shumë e qartë, sigurisht mund të jetë akumuluar ndonjë rezervë, ndonjë gjë, sepse opozita një pjesë të kohës nuk ka qenë në komision, janë të natyrshme edhe komentet, edhe preokupacioni, por ka ardhur koha të fokusohemi. Pa u fokusuar, humbasim kohë të çmuar, hyjmë në debat. Kohën e retorikës e kemi shpenzuar të gjithë dhe nuk kemi çfarë të shpenzojmë. Përpara nesh ka vetëm një alternativë: t'i mbyllim sa më shpejt punët këtu, në mënyrë që t'i mundësojmë Kuvendit të përcaktojë kohën e mbledhjes së seancës. Çdo gjë që ne do të bëjmë, që na largon kundrejt këtij përcaktimi të qartë, pra kur e konkludojmë, seanca është ajo që e konkludon çështjen, ne jemi jashtë kohës dhe jashtë vendit.

Themelin e gjësë e kemi, pranimin për vetingun e kemi, të gjithë bashkë e kemi bërë, nuk kemi dilema për këtë punë. Më lejoni të bëj një analogji: kjo është si puna e profesionit tim që po ta shikojnë 7 mjekë, të gjithë kanë mundësi të shtojnë elemente të reja, po nga i njëjti vokacion vuajnë edhe juristët. Problemi është që ne principlialisht i kemi zgjidhur gjërat. Pyetjes: veting, apo jo?, i jemi përgjigjur po. Në Kushtetutë, apo jo? Po, është në Kushtetutë. Elementeve

thelbësore që përcaktojnë kornizën u kemi thënë po në Kushtetutë. Pra, për mendimin tim kemi hequr të gjitha elementet parimore.

Nëse kemi një apo dy çështje, gjëra të cilat mund të qartësohen shumë shpejt, ne duhet të jemi me objektivin që jo vetëm për këtë, por edhe për dy ligjet e tjera të përcaktojmë një kalendar, edhe intensiv, të punës së komisionit, çdo sakrificë ia vlen, por ia vlen në funksion që ne këto t'i çojmë në sallë dhe t'i miratojmë atje. Të gjitha sakrificat që shkojnë përtej shtatorit janë sakrifica që nuk i hyjnë në punë kurrkujt. Të jemi fare të qartë me njëri-tjetrin.

Për ta mbyllur: më duket ushtrim shumë më i lehtë ky sesa ushtrimi i kaluar më 21 korrik. Aty kishim akumuluar rezerva, merake, gjëra të akumuluar në kohë, subjektive, objektive dhe kapërcimi i tyre na lehtëson edhe këtë punë. Tani duhet konstruktivitet dhe fokusim në gjëra, të cilat vërtet përbëjnë një merak të madh qoftë për opozitën, por edhe në pikëpamje të shkrimit të ligjit, i cili mund të kërkojë ndonjë gjë. Kështu që unë mendoj se ne duhet të përcaktojmë sesi do të ecim me shpejtësi. Sot janë ditë që një gjë që mund të kërkojë tre ditë, të përpiqemi ta bëjmë brenda disa orëve, duke punuar me intensitet, nëse vërtet jemi kaq të përgjegjshëm sa duam ta mbyllim këtë proces.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka gjë tjetër? Nuk ka.

Më lejoni të jap një këndvështrim timin në lidhje me debatin që po bëhet dhe çështjen që kemi në shqyrtim.

Unë i përkas bindjes së padiskutueshme që ky është një projektligj tejet i rëndësishëm dhe ndoshta është një nga 2-3 projektligjet më të rëndësishëm që ka paketa e reformës në drejtësi. Ky është një projektligj i debatuar gjerësisht në komision nga anëtarët e komisionit. Ata kanë bërë vërejtje, kanë harxhuar kohë dhe energji. Natyrisht opozita nuk ka qenë e pranishme, por kjo ka qenë vendimmarrja e saj, për të mos qenë pjesë e këtij procesi dhe për ta bojkotuar procesin. Bojkoti nuk justifikohet duke sulmuar kolegët, sepse është e vërtetë që nuk ishte miratuar norma kushtetuese, por ne ishim shumë të qartë se çfarë kishim çuar në projekt, se çfarë kishte shqyrtuar Komisioni i Venecias dhe u punua paralelisht edhe me draftin kushtetues, edhe me ligjin. E kemi thënë qartë në këtë komision, që ato nene kushtetuese që do të pësonin ndryshime, do të reflektoheshin më pas. Që të jemi të ndershëm me njëri-tjetrin, kjo nuk është një praktikë unike, por është një praktikë e freskët në parlamentin shqiptar. Kushtetuta, nenet për dekriminalizimin kushtetues dhe ligji “Për dekriminalizimin” shkuan paralel dhe megjithëse

nuk e dinim fare se për çfarë nenesh do të bëhej fjalë në Kushtetutë, bëme një ligj. Në këtë tryezë i kemi të dy palët e autorëve të këtyre projekteve, kështu që nga kjo pikëpamje, edhe si standard nuk është i paparë dhe nuk është se nuk ekziston si precedent, por nuk besoj se kjo është thelbësore. Ne jemi shumë luajalë dhe kemi qenë shumë të ndërgjegjshëm kur kemi diskutuar në këtë komision edhe kur e kemi trajtuar në parim, edhe kur e kemi trajtuar nen për nen, edhe kur e kemi mbyllur këtë proces, kemi thënë se jemi të hapur për dy gjëra: për ndryshimet që do t'i bëhen projektit kushtetues për vetingun për aq sa do të ketë dhe për hir të së vërtetës, përveç formulës nuk pati ndonjë ndryshim tjetër dhe nuk është korrekte të thuhet e kundërta sot këtu.

Për gjërat për të cilat mund të ketë opinione opozita, kemi thënë këtu, pa qenë opozita në këtë komision, e kemi vlerësuar këtë, sepse kemi dashur që të marrim sa më shumë konsensus për këtë projekt, pavarësisht se ne jemi në maxhorancë dhe i kemi votat për ta votuar vetë projektligjin, por unë nuk e kuptoj kështu për sa kohë duam të bëjmë një reformë të qëndrueshme, për aq sa mund të jetë konsensuale, por kryesorja është që të jetë e qëndrueshme. Ky ka qenë motivi që ne nuk kemi thënë se meqë jemi në maxhorancë dhe i kemi votat, do ta votojmë dhe do ta kalojmë në tërësi. Jo, ne e kemi lënë të hapur apostafat. Me shumë respekt dhe me shumë durim, ju pritëm të sillnin opinionet, i lexuam me vëmendje ato dhe kemi pritur sot që të reflektojmë me respekt. Minimalisht një lloj kortezie, një respekt reciprok, duhej ta kishit dëshmuar edhe ju këtu dhe jo të kishit bërë të kundërtën ndaj kolegëve të maxhorancës.

Elementi i dytë që dua të them: është e vërtetë që ka ndryshime projekti kushtetues dhe ato janë reflektuar, por reflektimi në projektin kushtetues që u miratua në parlament me projektin që u paraqit, janë thjesht dhe vetëm për përbërjen e komisioneve dhe nuk ka ndonjë reflektim tjetër të madh. I gjithë aneksi dhe dispozitat tranzitore qëndrojnë në këmbë që nga dita e parë, që janë paraqitur në Kuvend. Natyrisht, kishte nevojë të reflektoheshin dhe u reflektua.

Opinionet e opozitës është i rëndësishëm jo vetëm se është opozita e vendit, jo vetëm sepse kjo është opozitë merr pjesë në qeverisjen e vendit sot si opozitë dhe nesër si maxhorancë, por edhe sepse sa më shumë zëra, sa më shumë kontribute, aq më pozitive është. Kështu e kemi parë ne të gjithë procesin e reformës dhe prandaj kemi thënë që ky është një proces gjithëpërfshirës edhe në nivel teknik, edhe në nivel politik.

Projektligji që kemi sot këtu ka reflektuar pikat 1 dhe 2, që i trajtova më lart, pra të gjithë debatin që kemi bërë këtu, në komision dhe procesverbalet janë

botuar, për të qenë korrekt dhe ndryshimet kushtetuese për aq sa janë. Tani është momenti që të gjithë këto komente, opinione, propozime, sugjerime të opozitës të reflektohen për aq sa është e mundur, që të jenë të reflektueshme. Këtu dua të them që duhet të jemi pak më modestë, nëse s'kemi qëllim tjetër. Jo çdo gjë që thoni ju është e vërteta mbi tokë, ashtu si edhe ne kemi thënë këtu gjëra që nuk i kanë pranuar edhe ekspertët. Janë procesverbalet dhe ne nuk kemi thënë: "Ra bota". Si ka mundësi? Ne jemi maxhorancë, unë jam kryetar i komisionit dhe mund të mos më pranohet një gjë. Jo, kjo është gjë normale. Është normale të diskutosh, të bësh një propozim, i cili nuk të pranohet dhe këtë proces duhet ta mirëkuptoni edhe ju si të tillë. Keni dhënë disa opinione dhe keni bërë disa propozime dhe një pjesë e tyre, i dëgjova me kënaqësi nga ekspertët, nga zoti Deville dhe nga zoti Smibert që një pjesë të tyre i konsiderojnë të pranueshme, pozitive dhe konstruktive. Shumë mirë! Por ato që nuk janë të tilla, nuk janë dhe nuk mund t'i fusni me forcë as ju, as ne. Kështu që, detyra është që ekspertët të bëjnë reflektimet, ndryshimet dhe sugjerimet konkrete, që të përputhen me standardet dhe me projektin kushtetues.

Tani dua të trajtoj çështjen që u shtrua këtu. A ka standarde për këtë gjë? Unë them një "Po" të madhe. Pse ka standarde?

Standardi i parë është projekti kushtetues. Ne kemi këtu një aneks kushtetues të plotë vetëm për vetingun. Ky është standardi i parë i madh, është standardi ynë kushtetues, i cili është vendosur, pavarësisht në duam apo nuk duam ne, në këtë tryezë. Ja pra, që e paskemi një standard kushtetues!

Dua të them edhe një gjë tjetër. Ne jemi kolegë dhe unë jam i hapur ta bëj këtë diskutim. Ky aneksi që ne kemi këtu, është aq i plotë, saqë me pak përjashtim zbatohet drejtpërsëdrejti, sepse aneksi ka frymën e një ligji. Që të jemi korrektë, ai ka natyrën e një ligji. Ne ia kemi dhënë këtë natyrë aneksit për shkak të veçorisë që ai kishte. Ne i kemi dhënë forcë kushtetuese, pra praktikisht aneksi është i aplikueshëm drejtpërsëdrejti, në ndryshim me ligjet e tjera. Unë jam dakord që normat kushtetuese duhet të shtjellohen, kurse këtu normat kushtetuese që kanë të bëjnë me vetingun, janë shtjelluar në aneks si për një ligj të veçantë. Me këtë nuk dua të them se nuk ka nevojë për ligjin. Ka nevojë për ligjin, sepse ka nevojë për detaje që duhen shtjelluar më tej. Pra, e kemi një standard kushtetues. Kemi aneksin.

Po standard tjetër a kemi? Po, kemi Komisionin e Venecias, i cili nuk ka dhënë një, por ka dhënë dy opinione: opinionin e ndërmjetëm dhe opinionin final. Mbi bazën e sugjerimeve në

opinionin e ndërmjetëm, janë bërë reflektimet tek aneksi dhe Komisioni i Venecias ka qenë më shumë se i vëmendshëm pikërisht te pjesa e vetingut, duke qenë se nuk kishte një model kaq të qartë dhe kaq të plotë dhe ai ka kontribuar në një mënyrë aktive për këtë gjë. Në opinionin final është thënë se janë marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet tona. Kjo do të thotë që Komisioni i Venecias është shprehur mbi aneksin, mbi parimet dhe mbi procedurën e organizimit të këtij procesi. Ja pra, që e paskemi edhe një standard tjetër.

Po standardi tjetër, cili është?

Ju i quajtet zyrat “zyra teknike”, por unë mendoj se zyrat përgjegjëse të drejtësisë në Bruksel janë më shumë se zyra teknike të thjeshta. Unë besoj se janë njerëz me fushëpunje të gjerë, me kompetenca dhe në dijeninë time, siç i kam dëgjuar edhe këtu, janë konsultuar edhe me Komisionin e Venecias, edhe me Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut për këtë projekt. Pra, e paskemi edhe një standard tjetër, sepse ata kanë bërë një analizë të plotë të vendimeve që ka pasur Gjykata Europiane të të Drejtave të Njeriut. Të paktën kështu e kam dëgjuar, është analizuar praktika, vendimmarrja e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kam dëgjuar nga ekspertët që kjo vendimmarrje e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikat e mëparshme janë analizuar nga ekspertët ndërkombëtarë këtu, për të cilët unë kam respekt për punën e jashtëzakonshme që kanë bërë për këtë projekt. Pra, edhe ky është një standard.

Në fund fare, natyrisht ka edhe modele, edhe praktika ku vetingu është realizuar dhe ekspertët kanë bërë analizën më të mirë.

Ekspertët ndërkombëtarë, që janë këtu të atashuar në mënyrë permanente, dhe ekspertët ndërkombëtarë të Brukselit kanë bërë analizën si të vendimmarrjeve që ka pasur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, ashtu edhe të rasteve të shteteve të ndryshme, që kanë aplikuar vetingun në vendet e tyre.

E gjithë kjo ka sjellë këtë projektligj, që ne duhet të ndihemi mirë që kemi arritur dhe po bëjmë të gjitha përpjekjet për të bërë një standard akoma më të mirë që do të shërbejë edhe për vendet e tjera dhe do të thuhet shpeshherë se do t’i referohen rastit “Shqipëria”. Nuk ka ndonjë gjë të keqe. Është pozitive.

Për sa i përket çështjes së besueshmërisë, në qoftë se ne do të vëmë pikën e dyshimit edhe tek ekspertët ndërkombëtarë, edhe të operacionit ndërkombëtar kjo nuk ka fund. Unë mendoj se qenia e ekspertëve ndërkombëtarë, puna që kanë bërë ata në këtë projektligj, por edhe prania e

operacionit të monitorimit ndërkombëtar në një implementim janë elemente besueshmërie për procesin dhe ky është një risk që po e merr BE-ja, që po e merr departamenti i drejtësisë së SHBA-ve, që bashkërisht ta ndërtojmë vetingun në këtë standard. Duhet të jemi pak luajalë dhe konstruktivë edhe me ta. Po marrin një risk edhe përpara vendeve të tjera, po marrin një risk edhe me anëtarët e BE-së dhe po u thonë: “Ne po implementojmë këtë gjë”. Ky është një risk jo i vogël. Neve na duket sikur është një gjë e zakonshme. Edhe ata kanë dilemat e tyre. Prandaj janë të preokupuar dhe duhet t’ua njohim dhe t’i respektojmë edhe këtë gjë atyre. Ky është një element shumë i fortë besueshmërie. Pse? Sepse para se ata të duan kredibilitetin e procesit në Shqipëri, duan kredibilitetin e vendit, por duan edhe kredibilitetin e zyrave të tyre dhe po punojnë për të gjitha këto elemente për të bërë një gjë sa më të mirë.

Tjetra që kam, këtu u përmend kapja. Dreqi e mori, ne sapo votuam një ndryshim kushtetues që opozita ka të drejtën, dikton në proces 6 kandidatura të komisionit. Janë 6 që do t’i zgjidhni ju. As tek ata dhe as te vetja nuk keni besim? Nga moria e kandidaturave që do të vijnë, ju do të thoni 1, 2, 3, 4, 5, 6. As tek ata nuk keni besim? Pse? Sepse ju vini në diskutim kapjen. Si mund të kapin? Ata do të marrin vendim. Nëse nuk u pëlqejnë faktet, nëse nuk u pëlqejnë provat, do t’i kthejnë mbrapsht. Do t’i thonë: nuk na bindin këto dhe kaq. Do të marrin vendim në kushtet që nuk i bindin provat. Në kushtet që i bindin provat do të marrin vendim, që është një vendim i bazuar në prova.

Mendoj se jo një këngë mund të këndohet çdo ditë. Është kënduar kjo kënga e kapjes dy vjet të tëra. Tani te ky rast, me këtë rol aktiv substancial, që ka marrë opozita në proces, minimalisht këtë nuk duhet ta pranoni më, por duhet të merrni të gjithë përgjegjësinë mbi veten, sepse është bashkëpërgjegjëse opozita, si maxhoranca, në implementimin e këtij ligji, sepse do të bëjë përzgjedhjen e njerëzve që do të bëjnë vetingun. Mendoj se duhet t’ia kursejmë një retorikë politike të panevojshme këtij procesi. Unë bie dakord dhe do të pëlqejë që t’i qëndroni asaj që ka thënë kryetari juaj i opozitës, në mos gaboj, nënkryetari i partisë, se ky është një proces ligjor. Për sa kohë është një proces ligjor, bëni një diskutim ligjor. Nuk bini dakord, ne votojmë. Nuk bie dakord, votohet, siç bëhet në parlament për çdo ligj tjetër. Mos e ngarkoni me retorikë politike.

Unë e kuptoj që keni probleme, sepse keni vështirësi. Njëri thotë kështu, tjetri e trajton politikisht në partinë tuaj, tjetri e atakon si procedurë ligjore. Kjo është një procedurë tjetër. Unë them t’ia kursejmë njëri-tjetrit. Të rrimë në procedurë ligjore.

Unë jam dakord me atë që tha zoti Vasili, që ne edhe kemi kohë, por edhe nuk kemi. Madje më shumë do të thosha se nuk kemi kohë për t'i miratuar të tri projektligjet në parlament. Unë besoj se edhe opozita është me këtë kohë të nevojshme, të domosdoshme që kemi për të ecur shpejt. Jam i bindur që bashkërisht, do të kontribuojë edhe opozita, për këtë gjë kam folur me zotin Bylykbashin, që të ecim sa më shpejt të mundemi. Besoj se kështu do të ndodhë. Gjëja e parë që do të duhet të bëjmë është të fokusohemi në dy-tri gjëra që janë të rëndësishme. Ekspertët të reflektojnë çfarë ka edhe në këtë reflektim të fundit mbi propozimet e sjella nga Grupi Parlamentar i PD-së në këtë komision.

Të vijmë në komision. Në momentin më të parë që ekspertët do të na thonë që mbaruan punë, nesër, pasnesër, sa të mbarojnë, të vijmë në mbledhje të komisionit, ta diskutojmë, ta votojmë dhe ta çojmë në Parlament.

Ndërkohë e di, jam shumë mirë në dijëni, si të gjithë ju, që dje keni marrë edhe dy projektligjet e tjera. Ka qenë një proces jo i lehtë edhe për ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë për të reflektuar ndryshimet kushtetuese, por edhe për të dakordësuar për çdo element. Nuk është gjë e lehtë, janë ligje të vështira edhe ato dy të tjerat, por besoj se do të keni mundësi që t'i shikoni me të njëjtin përkushtim dhe angazhim, me të njëjtin shpejtësi edhe ato dy projektligje, në mënyrë që paralelisht të tri projektligjet javën që vjen t'i çojmë në parlament.

Atëherë edhe një herë faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po konkluzionet mbas meje nuk mund të bësh. Flas i fundit unë.

Tani, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, unë të lë edhe 20 minuta, jo më 2 minuta. Dakord.

Unë kam durim të madh tek ajo e opozitës, kam respekt për opozitën.

Gent Strazimiri - Zoti kryetar, nëse do të dëshironit që komentet tuaja të jenë ezauruese, ato nuk duhet të përmbajnë retorikë ose duhet të mbajnë retorikë në mënyrë të moderuar. Një pjesë e mirë e atyre që thatë nuk janë të vërteta, nuk qëndrojnë, duke nisur që nga fakti që thatë se me durim na pritët, megjithëse vendosët të bojkotonit. Nuk na pritët, ecët 1 vit e gjysmë për sa kohë kishit votat. Pastaj u kujtuat në darkë se nuk kishit votat. Të kishit pasur votat, nuk do të ishit këtu. E para, dhe këtë e dimë. Procesverbalet janë dhe gjërat kanë ndodhur në sytë e mediave.

Jemi në këtë fazë, ku do ta shohim ligjërisht gjënë. Unë nga natyra jam njeri dyshues edhe ndaj bindjes sime kur vjen puna për gjërat teknike dhe kaq komplekse. Për sa kohë, veçanërisht tani që e shoh thjesht të dyshuar dhe të palexuar gjënë, materiali për të cilin jemi të thirrur të japim një mendim është një material tejet kompleks, ai duhet lexuar edhe me laps në dorë.

Tani këtu ka dy gjëra nga i gjithë optimizmi që ju shprehët: ose ke marrë dhe lexuar me laps në dorë dhe të ka pëlqyer, ndryshe nga ne, që e dëgjojmë për herë të parë këtu, ose optimizmi që ke është i tillë, që mua më bën të dyshoj. Kështu që herë tjetër, nëse do t'i kontribuosh frymës së bashkëpunimit në këtë komision, mos u trego kaq optimist për gjënë, sepse më është thënë në mënyrë eksponenciale dyshimi për materialin, duke pasur parasysh të gjithë historinë tonë politike, veçanërisht të një viti e gjysmë, 2 vjet që po merreni me Komisionin e Reformës në Drejtësi. Kështu që nëse duhet të flasim për çështje teknike, le t'i lëmë ekspertët të flasin teknikisht. Me retorikë politike është rruga më e gabuar, më e keqe për ta zgjatur dhe stërzgatur procesin, veçanërisht kur thoni që me sa dashamirësi na keni pritur dhe nuk keni ecur pa ne.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ju falënderoj për 2 minutat tuaja ndaj meje, nuk është pak!

Faleminderit.

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, konfirmoj atë që thatë dje pasdite, që komisioni ka marrë në institucion dy projektligje të rëndësishme, të cilët janë po aq të rëndësishëm sa ky, madje në afatgjatë janë më të rëndësishëm se ky. Ne të gjithë duhet të fokusohemi fort për të parë që përfundimisht ato ligje janë që duhet dhe nuk mund të gjejmë nesër probleme të rënda në zbatim të Kushtetutës.

Kështu që t'u japim ekspertëve kohën e mjaftueshme që të punojnë, në kohën më të shkurtër të mundshme t'i vënë në dispozicion dhe parlamenti të ketë mundësi që ky komision e më tutje çdo procedurë parlamentare të ezaurojë miratimin e atyre dy projektligjeve.

Unë besoj, i nderuar kryetar dhe zoti Majko, se retorika, ku edhe unë marr pjesë, e tepërt për sa kohë, që në fillim e thamë: dëgjuam një analizë, prezantimi ishte i pamjaftueshëm për të gjykuar, ka shumë mundësi që problematika të jetë e tëra e zgjidhur. Nuk pretendojmë që ne kemi, po themi, dijen përfundimtare, as ju nuk e keni, ndoshta as të gjithë bashkë nuk e kemi. Prandaj themi të ulen ekspertët, gjë që nuk e kanë bërë deri më sot, të ulen dhe ta zgjidhin.

Ekspertiza është mirë që të jetë jo e ndarë. Ekspertët ndërkombëtarë këtu janë të paanshëm, ne këtë e dimë, për rrjedhojë na kontribuojnë tek arritja e një konsensusi. Nuk jemi më as tek ajo historia e diskutimit të nivelit shumë të lartë që i duhej Kushtetutës për t'u bërë dy- tri herë, domethënë për të ardhur deri tek ajo që miratuar më 22 korrik. Ndaj, është mirë që ato histori taktikash jo shumë të pastra dhe okulte në njëfarë mase se si duhet të ishin të ndarë ekspertët, gjë që bëri të pamundur pjesëmarrjen tonë në mënyrë konsekuente në të gjithë fazat e draftimit, ta eliminojnë.

Rikonfirmoj atë që tha zoti Vasili. Po, Kushtetuta është bërë, ky është tashmë proces ligjor, këto që shkruajmë ne maten në Gjykatë Kushtetuese dhe më larg. Ne nuk e duam që të shkojnë atje. Gjykatës Kushtetuese ia hoqëm të drejtën të shqyrtojë, së paku, parimet e asaj që kemi shkruar në Kushtetutë. Arsyeja? Në fakt, këtë nuk e mbështeti as Komisioni i Venecias, por nuk ka rëndësi. Pra, te ky proces, që është shumë teknik dhe ligjor, besoj se gjënë më të mirë na e thjeshtojnë ekspertët. Kështu që morëm të gjithë këtë kohë kot për të diskutuar me njëri-tjetrin, e kishim mbyllur më herët. Po të kursenim retorikën, ndoshta edhe unë, e kishim mbyllur më herët.

Kështu që ju falënderoj, t'u japim kohën e duhur ekspertëve për ligjin e vetingut, të vazhdojnë e ta mbyllin, të shohim deri në ç'masë, dhe të diskutojmë për dy ligjet e tjera.

Fatmir Xhafaj- Faleminderit për mirëkuptimin dhe meakulpën tuaj për këtë gjë! Besoj se sapo të na njoftoni ju, ne jemi gati. Po ju presim.

Faleminderit!

Këtu mbyllet mbledhja.

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë